



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3079/4 prot.

Datë, 17.12.2025

V E N D I M
Nr. 1871/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.12.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)”, me nr. REF-66479-10-23-2025, me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,308,000 (tre milion e treqind e tetë mijë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK, me Nipt. M51901012F dhe adresë Vaqarr, Magazine 1 katëshe, mbas kështjellës Konti, Zona Kadastrale 3712, Numer pasurie 18/54, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do bëhet nga të 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)”, me nr. REF-66479-10-23-2025, me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,308,000 (tre milion e treqind e tetë mijë) lekë pa tvsh., parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 29.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/6021 dhe me nr. 3079/2025 prot., datë 30.10.2025, e operatorit ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

“1. Dizajni i Dorezës

Keni kerkuar: Dorezë e rrotullueshme dhe e palosshme 360?.

Kërkesa për një dorezë të rrotullueshme dhe të palosshme duket se bazohet në një dizajn specifik mekanik. Mjetet tona të shpëtimit kanë një njësi kontrolli të patentuar - Star Grip - e cila lejon akses të plotë 360? dhe funksionim ergonomik nga çdo kënd, pa pasur nevojë për një dorezë rrotulluese ose të palosshme. Ky dizajn ofron përdorshmëri dhe siguri superiore në skenarë të kufizuar ose kompleksë shpëtimi.

Ne sugjerojmë me mirësi të rishikohet kërkesa për t'u përqendruar në aksesin funksional dhe funksionimin ergonomik,

Limiti i Peshës

Keni kerkuar: ?Pesha për përdorim max 13.8 kg dhe Pesha pa bateri max 13 kg

Ndërsa disa paisje qe jane ne treg, tejkalon pak limitin e specifikuar të peshës (me afërsisht 10%), ato ofrojnë performancë dukshëm më të lartë, duke përfshirë forcë më të madhe përhapjeje dhe gjerësi hapjeje. Ne besojmë se një kufizim i rreptë peshe mund të përjashtojë shume operatore që ofrojnë aftësi superiore shpëtimi.

Në vend që të aplikohet një prag i rreptë peshe, ne propozojmë që kriteret e vlerësimit të përshtaten për të zbatuar një sistem vlerësimi të ponderuar ku performanca e rritur mund të kompensojë devijimet e vogla në peshë. Kjo qasje do të lejonte një vlerësim më të balancuar dhe të orientuar drejt rezultateve të mjeteve të shpëtimit, duke siguruar që zgjidhjet me performancë të lartë të mos përjashtohen për shkak të kufizimeve të ngurta fizike.

Kekrojne qe ky kriter te ndryshoj, sepse perben perjashtim per operatoret e tjeret te tregut

Kërkesa për Dimensione Minimale

Keni kerkuar: Dimensionet min. 800x190x240 mm max.815x195x245mm

Përfshirja e një kërkesë minimale për dimension është e paqartë. Ndërsa dimensionet maksimale janë të kuptueshme për shkak të kufizimeve të hapësirës në automjetet e shpëtimit, një madhësi minimale mund të përjashtojë panevojshëm modelet kompakte dhe efikase.

Disa prodhues European, kane dimensione me te vogla, qe variojan min tek 790x20x250 mm, por ofrojnë performancë më të lartë, gjë që është veçanërisht e dobishme në mjediset e kufizuara të shpëtimit. Ne kërkojmë me mirësi që kërkesa minimale për dimension të rishqyrtohet ose të hiqet

për të lejuar zgjidhje më kompakte dhe inovative.

Ne e vlerësojmë konsideratën tuaj që ky kriter të ndryshoj, sepse perben kusht për perjashtimin e operatoreve të tjere

Specifikimi i Baterisë

Keni kërkuar: Bateri e karikueshme Minimumi 28V / 5Ah

Kërkesa për një tension minimal të baterisë prej 28V dhe kapacitet prej 5Ah nuk pasqyron me saktësi performancën aktuale ose efikasitetin operativ të mjeteve të shpëtimit. Vetëm tensioni nuk është një tregues i besueshëm i prodhimit të energjisë ose kohës së funksionimit. Për shembull, ka ne treg sisteme që përdorin një bateri 25.2V me menaxhim të optimizuar të energjisë, duke rezultuar në një kohëzgjatje më të gjatë operationale krahasuar me sistemet konkurruese me tension nominal më të lartë.

Ne rekomandojmë që specifikimi të rishikohet për t'u përpunuar me standardin EN 13204:2025, i cili përfshin kohën e funksionimit të baterisë në kushte të përcaktuara të ngarkesës si një kriter kyç të performancës. Kjo qasje siguron që mjetet të vlerësohen bazuar në qëndrueshmërinë e tyre aktuale operationale, e cila është shumë më e rëndësishme në skenarët e shpëtimit sesa në vlerat nominale elektrike.

Duke miratuar këtë metrikë të bazuar në standard, tenderi do të promovonte konkurrencën e drejtë dhe do të inkurajonte përzgjedhjen e mjeteve që ofrojnë performancë në botën reale, pavarësisht nga tensioni ose vlerësimet e tyre në amper-orë.

Nisur nga pikat sa më larte, kërkojmë: Ndryshimin e specifikimeve teknike, për hapjen dhe pjesëmarrjen e sa më shumë operatoreve ekonomik..”

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.35108/5 prot., datë 17.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3079/1 prot., datë 18.11.2025 me objekt “Lidhur me ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt “ Blerje hapëse, prerëse hidraulike me bateri”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga autoriteti kontraktor. Referuar shkresës së mësipërme, rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur mospranim të saj

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për modifikimin e specifikimeve teknike të pajisjes hapëse prerëse hidraulike me 2 bateri të procedurë së prokurimit objekt – ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vren se,

III.1.1 Në Shtojcën 6, “*Formulari i Specifikimeve Teknike*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi,, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”

Pajisje hidraulike e kombinuar hapëse prerëse me bateri

Pajisje hidraulike e kombinuar hapëse prerëse me bateri lehtësisht e transportueshme nga një operator, për përdorim të shërbimit të MZSH-së sipas nevojës gjatë ndërhyrjeve operuese zjarrëfikëse. Janë të projektuara posacërisht për prerjen dhe përhapjen e pjesëve të automjetit. Ato përdoren në raste aksidentesh të automjeteve.

Pajisja duhet të jetë e certifikuar dhe në përputhje me EN 13204 në mënyrë që të sigurojë performancë maksimale si në prerje ashtu edhe në hapje dhe të funksionojë me anë të energjisë nga një bateri e karikueshme në trup 28V 5Ah, pjesë e pajisjes (e ndryshueshme), pa pasur nevojën e një burimi tjetër të jashtëm energjie. Të jetë e pajisur me 2 bateri si dhe me karikues për baterinë.

Dorezë e rrotullueshme dhe e palosshme 360°.

Pajisje hapëse prerëse hidraulike me bateri

Pajisja e kombinuar

- Gjerësia e përhapjes min. 265 mm
- Gjerësia e hapjes min. 220 mm
- Presioni nominal min. 700 bar
- Minimumi i forcës së përhapëse 32 kN
- Maksimum i forcës përhapëse 590 kN
- Pesha për përdorim max 13.8 kg
- Pesha pa bateri max 13 kg
- Dimensionet min. 800x190x240 mm max.815x195x245mm
- Klasa e prerjes EN (EN 13204) Duhet të plotësojë ose tejkalojë kërkesat minmale të klasave prerëse 1H, 2G, 3G, 4H, 5G

- Karikues për një bateri

110-230V

Periudha e garancisë pajisjes do të jetë jo më pak se një vit, gjatë së cilës ofërtuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike. Operatori do të marrë përsipër zëvendësimin e cdo pjese të prerëses në rast difekti për një periudhë 1 vjecare nga dita e dorëzimit të mallit.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.4. Në nenin 36, “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP-ja gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet, si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë

objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset*

dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *"specifikim teknik"* nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrijnë pretendime mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafëruar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 *“Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): *“Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar*”. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* parashikohet se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.”* Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga

një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se nëse një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë me reputacion.

III.1.6. KPP-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për modifikimin e specifikimeve teknike të pajisjes hapëse prerëse hidraulike me 2 bateri të procedurë së prokurimit objekt – ankimi, duke kërkuar rishikimin e e specifikimit *Dorezë e rrotullueshme dhe e palosshme 360°*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në vendimin e KSHA-së është sqaruar se ky specifikim nuk është i lidhur me një dizajn specifik mekanik por është vendosur për të siguruar një funksionalitet maksimal në kushte të kufizuara ndërhyrjeje dhe për të garantuar manovrueshmëri të plotë të mjetit shpëtues në çdo pozicion pune por nuk ka argumentuar nëse ndryshimi i këtij specifikimi mund të çojë funksionalitetin e pajisjes. Nga operatori ekonomik është kërkuar rishikimi i këtij specifikimi me argumentimin se prodhues të ndryshëm ofrojnë këtë pajisje me një njësi kontrolli të patentuar - Star Grip - e cila lejon akses të plotë 360° dhe funksionim ergonomik nga çdo kënd, pa pasur nevojë për një dorezë rrotulluese ose të palosshme.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në

performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë në lidhje me pajisjen, specifikime teknike dhe parametra të caktuar me qëllim performancën sa më të mirë të pajisjes, të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me specifikimin e **mësipërm** nga ana e autoritetit kontraktor ky tregues nuk është hartuar në përputhje me nenin 36 pika 3 germa “a” në drejtim të kërkesave funksionale ose të performancës. Autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimin e mësipërm në proporcion me objektin e prokurimit dhe duke i argumentuar teknikisht ato, në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.1.7.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për modifikimin e specifikimeve teknike të pajisjes hapëse prerëse hidraulike me 2 bateri të procedurë së prokurimit objekt – ankimi, me pretendimin se 2. *Limiti i Peshës Keni kerkuar: ?Pesha për përdorim max 13.8 kg dhe Pesha pa bateri max 13 kg. Ndërsa disa paisje qe jane ne treg, tejkalon pak limitin e specifikuar të peshës (me afërsisht 10%), ato ofrojnë performancë dukshëm më të lartë, duke përfshirë forcë më të madhe përhapjeje dhe gjerësi hapjeje. Ne besojmë se një kufizim i rreptë peshe mund të përjashtojë shume operatore që ofrojnë aftësi superiore shpëtimi. Në vend që të aplikohet një prag i rreptë peshe, ne propozojmë që kriteret e vlerësimit të përshtaten për të zbatuar një sistem vlerësimi të ponderuar ku performanca e rritur mund të kompensojë devijimet e vogla në peshë. Kjo qasje do të lejonte një vlerësim më të balancuar dhe të orientuar drejt rezultateve të mjeteve të shpëtimit, duke siguruar që zgjidhjet me performancë të lartë të mos përjashtohen për shkak të kufizimeve të ngurta fizike. Kekrojnë qe ky kriter te ndryshoj, sepse perben perjashtim per operatoret e tjeret te tregut, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik nuk ka argumentuar se si ky specifikim është hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe përse ky specifikim kufizon konkurrencën e lirë. Pra, operatori ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar. Në vendimin e KSHA-së cilësohet se vendosja e këtij specifikimi është bërë në përputhje me standartet ergonomike ndërkombëtare EN13204:2016.*

Në rastin konkret, KPP vlerëson, se për sa kohë që standardet janë miratuar nga një organ i

ngarkuar nga ligji, detyra e organit shqyrtues në përputhje me nenin 109 e vijues të ligjit për prokurimin publik, kufizohet në faktin nëse autoriteti kontraktor ka ndjekur ose jo në një nga metodat e parashikuara nga neni 36 i ligjit për hartimin e specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik nuk qëndron, pasi specifikimi teknik është hartuar sipas parashikimeve të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi janë mbështetur në standard ndërkombëtar.

Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se referuar nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, një ndër metodat në hartimin e specifikimeve teknike është dhe mbështetja në standardet kombëtare, dhe ato ndërkombëtare. Në rastin konkret specifikimi mbi peshën e përdorimit të pajisjes hapëse prerëse hidraulike me bateri është pëcaktuar në përputhje me standartet ergonomike ndërkombëtare EN13204:2016.

Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt - prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustifikuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar, ndaj në rastin KPP gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me specifikimin e **mësipërm** nga ana e autoritetit kontraktor ky tregues është hartuar në mbështetje e nenit 36, pika a) të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në funksion të funksionalitetit të pajisjes.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.7.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për modifikimin e specifikimeve teknike të pajisjes hapëse prerëse hidraulike me 2 bateri të procedurë së prokurimit objekt – ankimi, duke kërkuar që *kërkesa minimale për dimension të rishqyrtohet ose të hiqet për të lejuar zgjidhje më kompakte dhe inovative. Ne e vlerësojmë konsideratën tuaj që ky kriter të ndryshoj, sepse perben kusht për përjashtimin e operatoreve të tjere*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është paraqitur asnjë argument që të vërtetojë se ky specifikim teknik është hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe përse ky specifikim kufizon konkurrencën e lirë. Pra, operatori ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se për të lejuar zgjidhje më kompakte dhe inovative.

Referuar dokumentacionit të tenderit publikuar në SPE, si edhe ankesës së operatorit ekonomik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i specifikimeve teknike është nën përgjegjësinë e njësive përkatëse të autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje me rëndësinë që ka prokurimi i mallrave. Dokumentet e

tenderit duhet të jenë të qarta dhe të sakta në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i specifikimeve teknike, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Përcaktimi i drejtë i specifikimeve teknike, ndikon në përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë, ndaj edhe autoriteti kontraktor duhet t'i përpilojë me përgjegjësi dhe profesionalizëm ato. Referuar specifikimeve teknike të cituara më sipër Komisioni vëren, se AK ka publikuar shtojcën me specifikimet teknike ku për specifikimin teknik dimensionet ka përcaktuar parametra me permasa minimum dhe maksimum, pra ka vendosur ka vendosur dimensione minimale dhe dimensione maksimale.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me pajisjen e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë, në lidhje specifikime teknike dhe parametra të caktuara, me qëllim performancën sa më të mirë të pajisjes të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me specifikimin **e mësipërm** nga ana e autoritetit kontraktor ky tregues është hartuar në përputhje me nenin 36 pika 3 gërma “a” në drejtim të kërkesave funksionale ose të performancës.

Për sa referuar, pretendimet e ankimuesit nuk qëndron.

III.1.7.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për modifikimin e specifikimeve teknike të pajisjes hapëse prerëse hidraulike me 2 bateri të procedurë së prokurimit objekt – ankimi, duke kërkuar që *specifikimi Bateria e karikueshme Minimumi 28V / 5Ah të rishikohet për t'u përputhur me standardin EN 13204:2025, i cili përfshin kohën e funksionimit të baterisë në kushte të përcaktuara të ngarkesës si një kriter kyç të performancës. Kjo qasje siguron që mjetet të vlerësohen bazuar në qëndrueshmërinë e tyre aktuale operationale, e cila është shumë më e rëndësishme në skenarët e shpëtimit sesa në vlerat nominale elektrike.*

Duke miratuar këtë metrikë të bazuar në standard, tenderi do të promovonte konkurrencën e drejtë dhe do të inkurajonte përzgjedhjen e mjeteve që ofrojnë performancë në botën reale, pavarësisht nga tensioni ose vlerësimet e tyre në amper-orë. Nisur nga pikat sa me larte, kërkojme: Ndryshimin e specifikimeve teknike, për hapjen dhe pjesëmarrjen e sa me shume operatoreve ekonomik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, kërkesa e operatorit ekonomik për modifikimin e këtij specifikimi sipas standardit EN 13204:2025 është një kërkesë e bazuar në parashikimeve të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, referuar nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, një ndër metodat në hartimin e specifikimeve teknike është dhe mbështetja në standardet kombëtare, dhe ato ndërkombëtare.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë në lidhje me pajisjen, specifikime teknike dhe parametra të caktuar me qëllim performancën sa më të mirë të pajisjes, të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimin e mësipërm sipas standardit EN 13204:2025.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2024, datë 13.10.2024 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njehzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (mallra)”, me nr. REF-66479-10-23-2025, me objekt “Blerje hapëse prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,308,000 (tre milion e treqind e tetë mijë) lekë pa tvsh., parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “NOVA MOTOR SOLUTIONS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

